

Banka e Shqipërisë

STATISTIKAT E LLOGARIVE FINANCIARE PËR VITIN 2017

Departamenti i Statistikave, Banka e Shqipërisë.

DHJETOR 2018

HYRJE

Përmes këtij publikimi, Banka e Shqipërisë për herë të parë, ofron për publikun statistikën e Llogarive Financiare Kombëtare¹, bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, nr. 8269, datë 23.12.1997, i ndryshuar;
- Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare, 2017-2021;
- Ligjin “Për Statistikat Zyrtare”, nr. 9180, datë 05.02.2004, i ndryshuar;
- Vendimin nr. 17, datë 29.03.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e “Kodit të Praktikave për Statistikat në Bankën e Shqipërisë”.

Ndarja e përgjegjësiwe institucionale, si edhe mekanizmat e bashkëpunimit për përgatitjen e llogarive kombëtare përcaktohen në Memorandumin e Bashkëpunimit (MoU) ndërmjet Bankës së Shqipërisë, Institutit të Statistikave dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Koncretisht, MoU përcakton përgjegjësitë e secilit institucion në shkëmbimin e të dhënave statistikore, si edhe në prodhimin e treguesve/blloqeve statistikore krahas përgjegjësisë së raportimit të tyre në institucionet ndërkombëtare.

Si një pjesë e pavarur e Llogarive Kombëtare, llogaritë financiare ofrojnë një pamje të plotë, gjithëpërfshirëse të situatës financiare dhe marrëdhënieve financiare në ekonomi, përsa i përket sektorëve ekonomikë dhe instrumenteve financiare, përfshirë dhe marrëdhëniet me jorezidentët. Ato ofrojnë një tablo mbi operacionet dhe strukturën e sistemit financiar dhe tregojnë kanalet kryesore të përdorura për të përfutur dhe investuar burimet financiare.

Banka e Shqipërisë publikon statistikat e Llogarive Financiare Kombëtare në Aneksin Statistikor². Llogaria financiare, sipas tabelave bashkëlidhur këtij dokumenti është ndërtuar e detajuar për të gjithë sektorët e ekonomisë: sektorin e korporatave jofinanciare (S.11), sektorin e korporatave financiare (S.12), sektorin e qeverisë së përgjithshme (S.13), sektorin e ekonomive familjare dhe institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë individëve (S.14+S.15) dhe sektorin e jorezidentëve (S.2). Ajo paraqitet e plotë për vitet 2013-2017.

Materiali përmban katër seksione. Seksioni i parë paraqet kuadrin metodologjik të hartimit. Seksioni i dytë prezanton situatën e Llogarive Financiare në vitin 2017 dhe ecurinë e tyre në vite. Seksioni i tretë ndalet në lidhjen ndërmjet sektorëve institucionalë dhe seksioni katër analizon situatën e mjeteve dhe të detyrimeve financiare për çdo sektor të ekonomisë, pjesë e bllokut të Llogarive financiare.

¹ Konform Programit të Statistikave Zyrtare 2017-2021 dhe Kalendarit të Publikimit të Statistikave të Bankës së Shqipërisë.

² https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Llogaria_financiare_aneks_statistikor_dhjetor_2018_13440.xlsx

1. KUADRI METODOLOGJIK

1.1 ASPEKT I PËRGJITHSHËM

Llogaritë financiare janë një nga komponentët e llogarive kombëtare dhe mund të përshkruhen si një bllok (set) i strukturuar informacioni statistikor, i cili regjistron transaksionet financiare - gjendje dhe fluks - ndërmjet sektorëve institucionalë, si dhe ndërmjet tyre dhe jorezidentëve (pjesës tjetër të botës), kjo e detajuar edhe sipas instrumenteve të ndryshme financiare.

Llogaritë financiare konsiderohen një statistikë e derivuar, pasi ato bazohen në një grup të gjerë statistikash të tjera, duke përfshirë këtu, bilancin e pagesave, statistikën monetare dhe statistikën financiare të qeverisë. Agregimi i shumë burimeve të informacionit, bën që llogaritë financiare të jenë shumë të rëndësishme në analizat ekonomike, pasi ato bëjnë të mundur matjen e ndikimit të vendimeve financiare të shumicës së agjentëve ekonomikë (grupuar në sektorët institucionalë). Llogaritë financiare ofrojnë një tablo mbi operacionet dhe strukturën e sistemit financiar dhe tregojnë kanalet kryesore të përdorura për të përfutur dhe investuar burimet financiare.

Llogaritë financiare përbëjnë një burim të rëndësishëm informacioni për analiza të politikës monetare dhe stabilitetit financiar. Për politikën monetare është e rëndësishme të kuptohet rrjedhja e fondeve dhe instrumentet, ndërsa për stabilitetin financiar është e rëndësishme të kuptohet shkalla e ekspozimit ndërmjet sektorëve.

Një nga rezultatet kryesore të llogarive financiare konsiston në llogaritjen e kursimeve financiare në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, pra diferencën ndërmjet investimeve financiare dhe detyrimeve të ndërmarra gjatë një periudhe. Blerja e mjeteve financiare ose emetimi i detyrimeve në një sektor të caktuar tregon aftësinë huadhënëse ose nevojat për huamarrje që rrjedhin nga aktiviteti ekonomik në të njëjtin sektor.

Banka e Shqipërisë ka detyrimin për hartimin e statistikave të llogarive financiare sipas ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" nr. 8269, datë 23.12.1997, i ndryshuar; dhe Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare, 2017-2021.

Llogaritë financiare vjetore në Bankën e Shqipërisë përpilohen në përputhje me metodologjinë e sistemit evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale (ESA 2010). Manuali ESA 2010 (Sistemi Evropian i Llogarive) është një standard ndërkombëtar që shërben për hartimin e statistikave të llogarive financiare, për të gjitha vendet në Evropë.

Siç u përmend, llogaritë financiare janë një set i strukturuar informacioni statistikor, i bazuar në një organizim të qartë të elementeve të ndryshme të përfshira, të tilla si sektorët, instrumentet financiare, llojit të informacionit dhe kritereve të vlerësimit, elemente të cilat do të diskutohen më tej në këtë kapitull.

1.2 SEKTORËT INSTITUCIONALË

Sistemi i llogarive kombëtare i klasifikon njësitë institucionale në bazë të aktivitetit kryesor ekonomik dhe sipas rolit që luajnë në ekonominë e vendit. Për qëllime të llogarive financiare, subjektet rezidente grupohen në pesë sektorë. Në Tabelën 1 paraqiten sektorët kryesorë të ekonomisë dhe kodet përkatëse në ESA 2010. Sektori i korporatave financiare dhe qeverisë së përgjithshme detajohet më tej në nënsektorë si në Tabelën 2.

Tabelë 1. Sektorët sipas ESA 2010

Sektorët institucionalë	Përshkrimi
Korporatat jofinanciare (S.11)	Përfshihen njësi institucionale, të cilat janë subjekte juridike të pavarura dhe prodhues tregu, aktiviteti kryesor i të cilëve është prodhimi i mallrave dhe shërbimeve jofinanciare.
Korporatat financiare (S.12)	Përfshihen njësi institucionale, të cilat janë subjekte juridike të pavarura dhe prodhues tregu, aktiviteti kryesor i të cilëve është ofrimi i shërbimeve financiare.
Qeveria e Përgjithshme (S.13)	Përfshihen njësi institucionale të cilat janë prodhues jotregu ose kanë funksion kryesor rishpërndarjen e të ardhurave dhe pasurisë kombëtare, si dhe që financohen nga buxheti i qeverisë në më shumë se 50% të aktivitetit.
Ekonomitë familjare dhe NPISH (S.14+S.15)	Ekonomitë familjare dhe institucionet jo me qëllim fitimi (NPISH).
Ekonomitë familjare (S.14)	Ekonomitë familjare përbëhet nga individë dhe grupe individësh të cilët janë kryesisht konsumatorë. Ata ndajnë të njëjtën banesë, mbledhin një pjesë ose të gjitha të ardhurat dhe konsumojnë kolektivisht mallrat dhe shërbimet.
Institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të familjeve (S.15)	Përfshihen njësi ligjore të pavarura, u shërbejnë ekonomive familjare dhe nuk prodhojnë për tregun. Institucione të tilla i sigurojnë ekonomive familjare mallra dhe shërbime falas, ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse.
Pjesa tjetër e botës (S.2)	Njësitë institucionale jorezidente përfshihen në llogaritë financiare vetëm në rast se ato janë të angazhuara në transaksione me njësi rezidente.

Tabelë 2. Korporatat financiare (S. 12) dhe Qeveria e Përgjithshme (S. 13)

Sektorët institucionalë	Përshkrimi
Korporatat financiare (S.12)	Korporatat depozituese (S.121 + S.122 + S.123)
	Banka Qendrore (S.121)
	Korporatat paradepozituese (Bankat tregtare) (S.122)
	Korporata depozituese të tjera (Shoqëritë e Kursim Kreditit) (s.123)
	Korporata të tjera financiare përveç Kompanive të Sigurimeve dhe Fondeve të Pensioneve (S.124 + S.125 + S.126 + S.127)
	Fondet e investimit jokorporata depozituese (S.124)
	Ndërmjetës të tjerë financiarë përveç kompanive të sigurimeve dhe fondeve të pensioneve (S.125)
	Ndihmësit financiarë (S.126)
	Kompanitë e financimit të kontrolluara nga kompani të tjera (captive financial institutions) dhe huadhënësit e parave (money lenders) (S.127)
	Kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensioneve (S.128 + S.129)
	Kompanitë e sigurimit (s.128)
Fondet e pensionit (s.129)	
Qeveria e Përgjithshme (S.13)	Qeveria qendrore (përfshijë fondet e sigurimeve shoqërore) (S.1311)
	Qeveria lokale (përfshijë fondet e sigurimeve shoqërore) (S.1313)
	Fondet e sigurimeve shoqërore (S.1314)

1.3 INSTRUMENTET FINANCIARE

Në llogaritë financiare, informacioni organizohet gjithashtu, edhe sipas llojit të transaksionit financiar, - të detajuar në 8 lloje kryesore të instrumenteve financiare. Klasifikimi i instrumenteve financiare konsideron kryesisht shkallën e likuiditetit, tregtueshmërinë, si dhe karakteristikat ligjore të mjeteve dhe detyrimeve financiare. Tabela 3 jep klasifikimin e instrumenteve financiare sipas ESA 2010.

Tabelë 3. Klasifikimi i instrumenteve financiare sipas ESA 2010

Instrumentet financiare	Përshkrimi
Ari monetar dhe SDR (F.1/ AF.1)	Ari monetar është ari i zotëruar nga autoritetet monetare (ose që ndodhet nën kontrollin efektiv të tyre) dhe që mbahet me cilësinë e mjetit të rezervës. SDR-të janë mjete të rezervës të krijuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për të plotësuar mjetet e tjera të rezervës që u janë akorduar periodikisht anëtarëve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, në përpjesëtim me kuotat e tyre.
Monedha dhe depozita (F.2/ AF.2)	Monedha dhe depozitat janë paraja në qarkullim dhe depozitat, si në monedhë vendase ashtu dhe në valutë të huaj.
Letra me vlerë të borxhit (F.3/ AF.3)	Letra me vlerë të borxhit janë instrumente të tregtueshme financiare që shërbejnë si evidencë e borxhit.
Huatë (F.4/ AF.4)	Huatë përfaqësojnë aktive financiare, të cilat krijohen kur kreditorët u japin në mënyrë të drejtpërdrejtë debitorëve fonde hua dhe bëhen të evidentueshme me dokumente që nuk janë të negociueshme.

Aksione ose njësi të fondit të investimit (F.5/ AF.5)	Aksione ose njësi të fondit të investimit janë pretendimet e mbetura në aktivet e njësisve institucionale që kanë emetuar aksionet apo kuotat pasi të gjitha pretendimet e tjera janë shlyer.
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit të jetës dhe pensionit vjetor (F.6/ AF.6)	Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit të jetës dhe pensionit vjetor përfaqësojnë rezerva teknike për sigurimin e jetës, të drejta dhe pretendime për sigurimin e jetës apo fondet e pensionit.
Derivatvët financiare (F.7 / AF.7)	Derivatvët financiare u referohen instrumenteve financiare që janë të lidhur me një tjetër instrument financiar ose mall dhe nëpërmjet të cilëve risqet specifike financiarë mund të transferohen dhe tregtohen në tregjet financiare
Llogari të tjera të arkëtueshme/pagueshme (F.8/ AF.8)	Llogari të tjera të arkëtueshme/pagueshme janë aktive dhe detyrime financiare të krijuara si kundërparti e transaksioneve që kanë një diferencë kohore midis transaksionit dhe pagesësave korresponduese.

1.4 LLOJET E INFORMACIONIT

Sistemi i llogarive kombëtare regjistron dy lloj informacionesh, flukset dhe gjendjet (Stokun). Flukset financiare janë veprime ekonomike ose ndryshime që ndodhin gjatë një periudhe të caktuar kohore. Gjendjet janë pozicionet në mjete dhe detyrime financiare në një moment të dhënë në kohë. Diferenca mes dy gjendjeve, përfshin në vetvete disa lloje fluksesh: (i) transaksionet, (ii) rivlerësimet dhe (iii) ndryshime të tjera në vëllimin e mjeteve financiare.

Transaksionet përfshijnë krijimin, shlyerjen, blerjen dhe të gjitha ndryshimet në pronësinë e mjeteve financiare nëpërmjet kontratave të dyanshme.

Rivlerësimet përfshijnë ndryshimin në vlerën e mjeteve financiare, që rrjedhin nga ndryshimet në çmimet e tyre. Rivlerësimet ndahen në:

- ndryshime të çmimit të tregut: ndryshime në çmimin e tregut të mjeteve financiare;
- ndryshime në kursin e këmbimit: ndryshime në vlerën e mjeteve të emetuara në valutë të huaj kur shprehen në monedhën vendase, për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit.

Ndryshime të tjera në vëllimin e mjeteve/detyrimeve financiare regjistrojnë: (i) ngjarje të zakonshme ose të jashtëzakonshme, që shkaktojnë hyrjen/daljen e mjeteve financiare dhe detyrime nga sistemi; dhe (ii) riklasifikimet statistikore dhe axhustimet, të cilat mund të prekin seritë kohore.

Figurë 1. Marrëdhënia ndërmjet llojeve të ndryshme të informacionit



Të dhënat gjendje (stock) në llogarinë financiare, japin informacion mbi pozicionet në mjetet financiare dhe detyrimet në një moment të dhënë kohor, të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë (përfshirë dhe pjesën tjetër të botës), duke mundësuar kështu vlerësimin e pasurisë financiare neto (pozicionin financiar neto) për secilin sektor.

Transaksionet financiare përshkruajnë veprimet ekonomike të ndodhura gjatë një periudhe të caktuar kohore ndërmjet sektorëve, pra investimet e tyre financiare dhe financimin, duke mundësuar kështu vlerësimin e huamarrjes/huadhënies neto të secilit sektor dhe të gjithë ekonomisë kundrejt botës.

1.5 MATRICA 'NGA KUSH - TEK KUSH' DHE RRJEDHA E FONDEVE

Matrica "nga-kush-tek-kush" është një paraqitje tredimensionale e transaksionit financiar, e cila përfshin jo vetëm paraqitjen e të dyja palëve të transaksionit (debitorin dhe kreditorin), por njëkohësisht edhe instrumentin financiar, që është objekt i transaksionit. Llogaria financiare "nga-kush-tek-kush" njihet gjithashtu, dhe si matrica e rrjedhës së fondeve.

Hartimi i llogarive financiare në formë matrice "nga kush-tek kush" mundëson një prezantim të hollësishëm të financimit dhe investimeve financiare përmes instrumenteve financiare. Kështu, ajo mundëson analizën e marrëdhënieve ndërmjet sektorëve dhe nënsektorëve institucionalë brenda një ekonomie dhe gjithashtu, ndërmjet këtyre sektorëve dhe nënsektorëve dhe jorezidentëve. Një analizë e tillë, hedh dritë mbi përbërjen sektoriale në mjete dhe detyrime, si dhe mbi pikat e forta dhe dobësitë e mundshme në portofole investimi. Llogaritë financiare në formatin e matricës 'nga kush tek kush' kompilohen si për të dhënat stok (gjendje) dhe për transaksionet. Matrica është e ndërtuar si vijon: në kolona paraqiten sektorët kreditorë, të detajuar sipas ESA 2010. Në rreshta paraqiten instrumentet financiare të detajuara për secilin sektor debitor. Kështu, të gjitha qelizat e përcaktuara në matricë përmbajnë informacionin si vijon: sektorin kreditor, sektorin debitor, instrumentin financiar dhe njëkohësisht klasifikimin në mjete/detyrime të matricës, duke lejuar kështu hartimin e llogarive financiare në formatin "nga kush - tek kush" me një strukturë shumëdimensionale. Kjo paraqitje mundëson përgjigjen ndaj pyetjeve të tilla si: "Cili sektor financon cilin, në çfarë volumi dhe përmes cilit instrument financiar? Një strukturë e tillë, përpos përdorimit në analiza të ndryshme, na siguron edhe kontrollin e të dhënave. Pasi është përcaktuar burimi i informacionit, çdo qelizë brenda matricës kërkon detyrimisht një vlerë. Në këtë mënyrë mund të përcaktohen vlerat që mungojnë. N.q.s. ka më shumë se një burim për një vlerë të vetme, atëherë hierarkia e burimit përcakton vlerën (shifrën) që do të përdoret në vlerësim. Nga pikëpamja statistikore, ngritja e llogarive në baza "nga kush - tek kush" është një mënyrë e rëndësishme për rritjen e cilësisë dhe konsistencës së të dhënave. Kjo lejon kontrollin e kryqëzuar të të dhënave nga të dyja anët, e debitorit dhe kreditorit, duke mundësuar kështu konsistencë të plotë në aspektin e vlerave dhe kohës së regjistrimit të transaksioneve dhe nivelit stok (gjendje).

HAPËSIRË INFORMUESE 1. PËRDORIMI I LLOGARIVE FINANCIARE NË ASPEKTE TË ANALIZËS

Llogaritë financiare përbëjnë një shtyllë të rëndësishme statistikore për analiza të politikës monetare dhe stabilitetit financiar. Për politikën monetare është e rëndësishme të kuptohet rrjedhja e fondeve dhe instrumentet, ndërsa për stabilitetin financiar është e rëndësishme të kuptohet shkalla e ekspozimit ndërmjet sektorëve. Nga pikëpamja e politikës monetare, llogaritë financiare tregojnë burimin e financimit të sektorëve ekonomikë, duke dhënë një informacion të shtuar mbi strukturën e ekonomisë dhe ekspozimin e sektorit të brendshëm ndaj atij jorezident. Gjithashtu, këto llogari japin informacion mbi instrumentet e financimit, p.sh., nëse një sektor financohet me kredi bankare apo me instrumente të tjera. Lloji i instrumentit është i rëndësishëm për të përcaktuar zgjerimin e masës monetare në ekonomi.

Nga pikëpamja e stabilitetit financiar, llogaritë financiare analizohen si një rrjet ekspozimesh të ndërlidhura, edhe pse përkufizimet për vlerësimin dhe konceptet janë më shumë makroekonomike sesa të orientuara drejt rrezikut. Megjithatë, ndërlidhjet sektoriale mund të ndihmojnë për të zbuluar mekanizma të transmetimit të rrezikut. Në këtë kontekst, analiza e këtij rrjeti mund të zbulojë se edhe pse një pjesë e sistemit financiar që konsiderohet veçanërisht e qëndrueshme ndaj një skenari të caktuar negativ, ende mund të ndikohet për shkak të ndërlidhjes së tij të ngushtë me sektorët e prekur direkt nga ngjarje të paparashikuara. Rëndësia e kësaj analize u evidentua veçanërisht pas ngjarjeve dhe efekteve që pasuan krizën financiare globale (2008-2009). Këto ngjarje theksuan nevojën që analiza e stabilitetit financiar të synojë identifikimin e lidhjeve midis sektorëve dhe kanalet përmes të cilave, goditje lokale mund të përhapen gjerësisht në sistemin financiar. Ky rrjet ekspozimi ndërsektorial përdoret gjerësisht në analizat e stabilitetit financiar nga FMN dhe BQE.

1.6 BURIMET E TË DHËNAVE

Tabela e mëposhtme ilustron burimet kryesore për përpilimin e llogarive financiare.

Tabelë 4. Burimet e të dhënave për llogarinë financiare

Sektorët dhe nënsektorët	Burimi i informacionit	Afati i raportimit	
Korporatat jofinanciare (S.11)	INSTAT	Sipas MoU	
Korporatat financiare (S12)			
Institucionet monetare dhe financiare (IMF) (S.121+S.122)	Banka qendrore (S.121)	BSh 10 ditë pas muajit referencë	
	Institucionet e tjera monetare dhe financiare (S.122)	Bankat para-depozituese	BSh 30 ditë pas muajit referencë
		Shoqëritë e Kursim-Krediit	BSh 50 ditë pas tremujorit referencë

Korporata të tjera financiare përveç institucioneve monetare dhe financiare, kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensioneve (S.124+S.125+ S.126 +S.127)	Fondet e investimit përveç fondeve të tregut të parasë (S.124)	AMF	90 ditë pas tremujorit referencë
	Ndërmjetës të tjerë financiarë, përveç kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit (S.125)	BSh	40 ditë pas tremujorit referencë
	Ndihmësit financiarë (S.126)	BSh, AMF, QKR	40 dhe 90 ditë pas tremujorit referencë
	Kompanitë e financimit të kontrolluara nga kompani të tjera (S.127)	BSh	40 ditë pas tremujorit referencë
Kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensioneve (S.128+S129)	Kompanitë e sigurimit (S.128)	AMF	90 ditë pas tremujorit referencë
	Fondet e pensioneve (S.129)	AMF	90 ditë pas tremujorit referencë
Qeveria e përgjithshme (S.13)		MoF	Sipas MOU
Ekonomitë familjare dhe institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë individëve (S.14+S.15)		BSh, INSTAT	INSTAT, BSh dhe vlerësim
Jorezidentët (Pjesa tjetër e botës) (S.2)		BSh	BSh

Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

Të dhënat merren në mënyrë direkte nga institucionet raportuese si burim primar, ose në mënyrë indirekte nga informacioni kundërpartit. Për mbledhjen e të dhënave primare, statistikave të llogarive financiare përdorin gjerësisht të dhënat të cilat BSH-ja i mbledh në përputhje me mandatin e saj si agjenci statistikore, nëpërmjet sistemit të unifikuar të raportimit (ERRS) dhe raportimeve të tjera në Bankën e Shqipërisë, ndërkohë që burime suplementare përdoren për të plotësuar mangësitë në burimet primare ose për të përmirësuar cilësinë e statistikave. Si burim kryesor informacioni për hartimin e llogarisë financiare përdoren dy blloqe të rëndësishme statistikore të Bankës së Shqipërisë: statistikave monetare dhe statistikave të sektorit të jashtëm. Të dhënat për kompilimin e llogarive financiare mund të merren nga secili prej dy pjesëmarrësve në çdo transaksion financiar³. Banka e Shqipërisë dhe INSTAT bashkëpunojnë⁴ ngushtësisht për të përdorur maksimalisht të dhënat administrative. Prodhimin e të dhënave të tilla për sektorin e ekonomive familjare përbën veçanërisht një sfidë. Në praktikë, pjesa më e madhe e të dhënave të këtij sektori marrin nga informacioni kundërpartit, duke përdorur statistikave të sektorëve të tjerë lidhur me pozicionet ose transaksionet me sektorin e ekonomive familjare.

Në rastet kur burime të ndryshme të të dhënave sigurojnë vlerësime kontradiktore, hartuesit e statistikave vlerësojnë cilësinë relative të burimeve. Burimet e disponueshme kategorizohen sipas një hierarkie, e cila u jep prioritet burimeve primare të informacionit, p.sh. duke konsideruar faktin se të dhënat bankare janë më të besueshme se të dhënat e individëve.

³ Përfundimisht bën ari monetar, për të cilin në konceptin statistikor nuk ekziston një kundërpartit.

⁴ Marrëveshja e bashkëpunimit mes Bankës së Shqipërisë, Institutit të Statistikave dhe Ministrisë së Financave u nënshkrua në fund të muajit shtator të vitit 2016.

2. PREZANTIMI I REZULTATEVE KRYESORE

Grafiku 1 dhe tabela 5 prezantojnë mjetet dhe detyrimet financiare të sektorëve institucionalë, dalluar në dimensione dhe klasifikime instrumentesh.

Mjetet dhe detyrimet financiare të sektorit të korporatave financiare paraqiten në volume të konsiderueshme krahasimisht me ato të sektorëve të tjerë. Kjo për shkak se institucionet e përfshira në këtë sektor veprojnë si ndërmjetës financiarë. Pozicionet me jashtë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të aktiveve dhe detyrimeve financiare të korporatave financiare.

Për sektorin e korporatave financiare, niveli i mjeteve dhe detyrimeve financiare është mjaft i balancuar. Ndryshe paraqitet situata e ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare. Për ekonomitë familjare, mjetet financiare në thelb tejkalojnë detyrimet, kryesisht për shkak se të nivelit të lartë të investimeve në formën e depozitave si dhe investimeve në formën e pjesëmarrjeve në kapitalin e korporatave jofinanciare. Në të njëjtën kohë, pretendimet ndaj korporatave të sigurimit dhe fondeve të pensionit që rrjedhin nga skemat e pensioneve profesionale përfshihen në mjete financiare të sektorit të ekonomive financiare (individët).

Për korporatat jofinanciare, detyrimet tejkalojnë pasuritë financiare në mënyrë të konsiderueshme. Kjo për faktin se: së pari, krahas kredive dhe letrave me vlerë të borxhit, detyrimet përfshijnë gjithashtu vlerën e tregut të aksioneve të emetuara nga korporatat; dhe së dyti, mjetet jofinanciare të korporatave të financuara nëpërmjet kapitalit dhe kapitalit të huazuar nuk janë raportuar në llogaritë financiare.


Krahasimisht me dimensionet e sektorëve të tjerë, mjetet dhe detyrimet financiare të sektorit të qeverisë së përgjithshme janë minimale.

Seksionin 4 në vijim, ofron një pasqyrim më të detajuar mbi zhvillimet në mjete dhe detyrime financiare të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

Tabelë 5. Stoku i mjeteve dhe detyrimeve financiare të sektorëve institucionalë, 2017

në miliardë lekë				
	Korporatat jofinanciare	Korporatat financiare	Qeveria e përgjithshme	Ekonomitë familjare
Mjete financiare				
Ari monetar dhe SDR	-	26	-	-
Monedha dhe depozitat	269	542	48	996
Letra me vlerë të borxhit	50	744	-	92
Huatë	57	704	49	3
Aksione ose njësi të fondit të investimit	66	28	223	568
Skema e sigurimit dhe pensionit	14	5	-	3
Derivate financiare	0	0	0	0
Llogari të tjera të arkëtueshme	632	26	172	101
Totali	1,088	2,075	492	1,764
Detyrime				
Ari monetar dhe SDR	-	7	-	-
Monedha dhe depozitat	-	1,624	-	-
Letra me vlerë të borxhit	39	7	587	-
Huatë	687	89	434	195
Aksione ose njësi të fondit të investimit	1,160	295	-	-
Skema e sigurimit dhe pensionit	-	19	-	-
Derivate financiare	0	0	0	0
Llogari të tjera të pagueshme	760	18	190	11
Totali	2,646	2,058	1,210	206

Grafik 1. Stoku i mjeteve dhe detyrimeve financiare të sektorëve institucionale, 2017
Mjetet financiare(+) / Detyrime financiare (-)




Konvencion/ Jo e aplikueshme: -
Konvencion/ Mungon informacioni: ..
Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

Hartimi i statistikave të llogarive financiare është shtrirë në kohë deri në vitin 2013. Tabelat 1 dhe 2 në shtojcën statistikore bashkëlidhur, paraqesin mjetet financiare dhe detyrimet e çdo sektori sipas instrumenteve kryesore të investimit. Duke analizuar të dhënat për periudhën 2013-2017, mund të kuptohet si kanë evoluar në kohë nevojat për financim të secilit sektor të ekonomisë.

Në dimensionin e ekspozimit neto, ekonomia shqiptare, në fund të vitit 2017, pozicionohet në huamarrës neto me rreth -702 mld lekë - me rritje vjetore rreth 17% krahasuar me vitin 2016 (-600 mld lekë).

Grafik 2: Pozicioni financiar neto i sektorëve të ekonomisë



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

Në harkun kohor të pesë viteve (2013-2017), mjetet financiare të të gjithë sektorëve ekonomikë u rritën me rreth 857 miliardë lekë (ose 14%), dhe në fund të vitit 2017 vlerësohen në 7,107 miliardë lekë. Në tërësi, të gjithë sektorët kanë zgjeruar aktivitetin e tyre, ku rritja më e madhe është vërejtur në sektorin jorezident dhe korporatat financiare.

Totali i mjeteve financiare të sektorëve të brendshëm të ekonomisë (sektorëve rezidentë), për vitin 2017, shënoi 5,419 miliardë lekë, në rritje me 9% në harkun kohor të pesë viteve (2013-2017).

Rreth 2,075 miliardë lekë (ose 38%) e totalit të mjeteve financiare të brendshme i përkasin sektorit të korporatave financiare. Ky sektor përbëhet nga banka qendrore (24%), korporatat e tjera depozituese (69%), fondet e investimit (4%), shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensionit (1%) dhe institucionet e tjera financiare (2%). Gjatë periudhës 2013-2017, mjetet financiare të sektorit financiar u zgjeruan me 321 miliardë lekë. Korporatat e tjera depozituese, në vite, janë dominuese në performacën e të gjithë sektorit financiar, duke zënë mesatarisht rreth 70% të totalit të mjeteve të sektorit dhe 26% të totalit të ekonomisë vendase. Institucionet e tjera financiare, përfshirë kompanitë e sigurimit dhe fondet e pensioneve dhe të investimit, kanë në total 153 miliardë lekë mjete financiare, si dhe kanë rritur shkallën e tyre të përfaqësimit (në 7%) të totalin e sektorit financiar, për shkak të zhvillimeve pozitive të fondeve të investimit.

Sektori i dytë më i rëndësishëm, ai i ekonomive familjare, zotëron rreth 33% të totalit të mjeteve financiare të brendshme. Në harkun kohor të 5 viteve, mjetet e këtij sektori u zgjeruan me rreth 88 miliardë lekë dhe në fund të 2017 shënojnë 1,764 miliardë lekë.

Biznesi ose korporatat jofinanciare zotërojnë rreth 1,088 miliardë lekë mjete financiare, shifër e cila përbën 20% të totalit të mjeteve të brendshme financiare.

Mjetet financiare në zotërim të qeverisë së përgjithshme vlerësohen në 492 miliardë lekë ose 10% të totalit të sektorëve rezidentë.


Sektori jorezident, i cili përfaqëson detyrimet e huaja të sektorëve të ekonomisë vendase kundrejt pjesës tjetër të botës, u zgjerua me 412 miliardë lekë gjatë harkut kohor 5-vjeçar. Ky sektor përfaqësoi 24% të totalit të mjeteve financiare, në fund të vitit 2017.

Në krahun e detyrimeve financiare, peshën kryesore e zë sektori i korporatave jofinanciare, me rreth 37% të totalit të detyrimeve të të gjithë sektorëve (ose 43% të sektorëve të brendshëm ekonomikë). Ky sektor ka zgjeruar detyrimet e tij me 49 miliardë lekë, që prej vitit 2013, dhe në fund të vitit 2017 shënon një total detyrimesh prej rreth 2,646 miliardë lekësh.

Sektori i korporatave financiare, zgjeroi detyrimet e tij me 352 miliardë lekë gjatë harkut kohor në shqyrtim, duke arritur nivelin e përfaqësimit 29% të totalit të detyrimeve të gjithë sektorëve (ose 34% të sektorëve të brendshëm ekonomikë).

Nga këndvështrimi i instrumenteve financiare, monedha dhe depozita (AF2) përfaqësojnë instrumentin financiar më të përdorur në ndërlidhjet sektoriale (me rreth 28% të totalit të mjeteve/ detyrimeve në fund të vitit 2017, Grafik 3), ndërkohë që huatë dhe instrumentet e kapitalit përfaqësojnë respektivisht 21.6% dhe 21.3% të totalit. Llogaritë e arkëtueshme/pagueshme zënë rreth 14% të mjeteve/detyrimeve dhe zotërohen në masën më të madhe nga korporatat jofinanciare.

Grafik 3. Pesha e Instrumentave financiare në ekonomi



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

3. MARRËDHËNIA NDËRMJET SEKTORËVE INSTITUCIONALË

Ky seksion synon të analizojë modelet e financimit të vendosura midis sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, si dhe mes tyre dhe jashtë vendit. Për këtë qëllim, informacioni mbi transaksionet financiare kombinohet me konceptin e shpjeguar më lart, në seksionin 1.5, rrjedhja e fondeve "nga kush-tek kush", në mënyrë të tillë që të mundësojë matjen e marrëdhënieve financiare ndërsektoriale në ekonominë shqiptare dhe shkallën e ndërveprimit të saj me botën (sektori jorezident).

Grafiku 4 paraqet ndërlidhjen financiare të sektorëve institucionalë. Ndërtimi dhe interpretimi i tij paraqitet në Hapësirën Informuese në vijim:

HAPËSIRË INFORMUESE: GRAFIKU I RRJEDHËS SË FONDEVE.

Grafiku i rrjedhës së fondeve është një formë e paraqitjes së sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, si dhe e marrëdhënieve financiare të vendosura midis tyre.


Kombinimi i disa faktorëve, si madhësia e elementeve të komponentit dhe ngjyrat e përdorura, lehtësojnë leximin dhe interpretimin e këtij grafiku.

Grafiku përmban dy elemente: nyjet dhe vektorët. Nyjet përfaqësojnë ekspozimin neto - diferencën e mjeteve dhe detyrimit financiar për secilin sektor. Ngjyra jeshile shfaq pozicion kreditor të sektorit kundrejt sektorëve të tjerë, ndërsa ngjyra e kuqe tregon pozicion debitor. Madhësia e rrethit është proporcionale me madhësinë e huadhënies/huamarrjes neto.

Vektorët pasqyrojnë ekspozimin bruto (totalin e mjeteve dhe detyrimeve që secili sektor zotëron me sektorë të tjerë). Nëse një sektor i dhënë paraqet një shigjetë drejt një sektori tjetër, kjo do të thotë se i pari është një huadhënës neto i këtij të fundit dhe anasjelltas. Një sektor është huadhënës neto kundrejt sektorit tjetër, kur diferenca ndërmjet mjeteve dhe detyrimeve në lidhje me këtë sektor është pozitiv.

Gjerësia e shigjetave është proporcionale me madhësinë e rrjedhës neto të fondeve të krijuar midis dy sektorëve.

Grafik 4: Ndërlidhja financiare e sektorëve institucionalë



Në dimensionin e ekspozimit neto⁵, ekonomitë familjare dhe sektori jorezident pozicionohen në kreditorë ose huadhënës neto, ndërkohë që, korporatat jofinanciare dhe qeveria e përgjithshme vijojnë në pozicion debitor ose huamarrës neto⁶. Për shkak të natyrës së biznesit, korporatat financiare vijojnë në pozicion pozitiv/ huadhënës neto edhe pse të ulët.

Sektori financiar, sektori korporata jofinanciare dhe ai jorezident evidentohen si sektorët kryesorë për sa i përket ekspozimit bruto⁷ (vektorët më të theksuar).

Gjithashtu, shkalla e integritit me jashtë (segmenti lidhës me sektorin jorezident) paraqitet e lartë për korporatat financiare - me një total të ekspozimit bruto prej 1,107 miliardë lekësh, rrjedhojë e investimeve në letra me vlerë, marrëdhënieve interbankare, depozitave të emigrantëve, si dhe pjesëmarrjes së huaj të kapitalit në sektorin bankar. I ilustruar me të dhënat në paraqitjen e llogarive financiare sipas matricës 'nga kush – tek kush' (Tabelë 6), ekspozimi bruto i sektorit të korporatave financiare me jashtë (jorezidentët) për llogaritjet si shumator i mjeteve (770) dhe detyrimeve (337) të korporatave financiare me jorezidentët (nivelet e ngjyrosura në Tabelën 6).

Tabelë 6. Paraqitja e llogarive financiare në matricën 'nga kush – tek kush' - fund i vitit 2017, në miliardë lekë

		Sektori Kreditor				
		Korporatat jofinanciare (S11)	Korporatat financiare (S12)	Qeveria e përgjithshme (S13)	Ekonomitë familjare (S14+S15)	Jorezidentët (S.2)
Sektori debitor	Korporatat jofinanciare	459	390	390	524	882
	Korporatat financiare	249	259	116	1,111	337
	Qeveria e përgjithshme	194	461	n/a	87	469
	Ekonomitë familjare	11	195	-	n/a	-
	Jorezidentët	174	770	0	42	n/a

Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

Korporatat jofinanciare kanë një total të ekspozimit bruto me jashtë prej 1,057 miliardë lekësh, rrjedhojë e investimeve të huaja direkte në sektorin jofinanciar. Qeveria e përgjithshme ka një vlerë të ekspozimit bruto prej 469 miliardë lekësh për shkak të nivelit të lartë të financimit të huaj në borxhin e qeverisë.

Financimi brenda sektorit – si në vlerë absolute, ashtu edhe në përqindje ndaj ekspozimit total bruto – vërehet më i lartë në sektorin e korporatave jofinanciare (në nivelin 459 miliardë lekë).

⁵ Diferenca ndërmjet mjeteve dhe detyrimeve financiare për secilin sektor.

⁶ Më gjerësisht, analiza e zhvillimeve të llogarive financiare për çdo sektor në seksionin 4.

⁷ Totali i mjeteve dhe detyrimeve financiare me sektorë të tjerë.

4. ZHVILLIMET SIPAS SEKTORËVE INSTITUCIONALE


4.1 SEKTORI - KORPORATAT JOFINANCIARE (S.11)

Gjatë vitit 2017, korporatat jofinanciare (ose ndryshe bizneset) shfaqën rënie të lehtë të nevojës për financim në rreth 1.04%. Pozicioni financiar neto i këtij sektori, në fund të vitit 2017, shënon -1,559 miliardë lekë nga -1,575 miliardë lekë në vitin 2016 (Grafik 9). Kjo ecuri u diktua kryesisht nga zgjerimi i kapitalit të kompanive (instrumenti “aksione ose njësi të fondit të investimit” (AF5)).


MJETET FINANCIARE

Në fund të vitit 2017, mjetet financiare të korporatave jofinanciare arritën në rreth 1,087 miliardë lekë, duke u zgjeruar lehtësisht me rreth 1% në terma vjetorë. Llogari të tjera të arkëtueshme (AF.8) mban pjesën më të madhe të mjeteve financiare të këtij sektori, në rreth 58.1% të totalit. Kredia tregtare përbën rreth 61% të instrumentit llogari të tjera të arkëtueshme dhe rreth 35% të totalit të mjeteve financiare, duke demonstruar rëndësinë e tij si burim financimi midis njësive institucionale të përfshira në sektorin e korporatave jofinanciare.

Grafik 5. Ecuria e mjeteve financiare të sektorit të korporatave jofinanciare (S11)



Grafik 6. Përbërja e llogarive të tjera të arkëtueshme për sektorin e korporatave jofinanciare (S11)



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

“Monedha dhe depozitat” (AF.2) u zgjeruan gjatë vitit me 9%, duke arritur nivelin 269 miliardë lekë. Kjo rritje është rrjedhojë e zgjerimit së bashku e: (i) likuiditeteve afatshkurtra të mbajtura në arkën e bizneseve (në 68.4 miliardë lekë, nga 60.4 miliardë në fund të 2016); (ii) llogarive rrjedhëse të mbajtura në korporatat depozituese (në 129 miliardë lekë, nga 124 miliardë lekë në fund të 2016); dhe (iii) depozitave me afat (AF29) (në 71.6 miliardë lekë, nga 62 miliardë lekë një vit më parë).

Nga ana tjetër, “huatë” (AF. 4) ranë në terma vjetorë me 12.5% - huadhënia e korporatave jofinanciare në fund të 2017 shënon 57 miliardë lekë nga rreth 65 miliardë lekë në fund të 2016. Ky kontraktim i detyrohet zvogëlimit të pretendimeve në formën e huasë me sektorët jorezidentë (huatë ndërkompani në marrëdhënie investimi direkt).

“Aksionet ose njësitë e fondeve të investimit” (AF.5) u zgjeruan gjatë vitit me 5%, duke arritur në rreth 66 miliardë lekë, dhe përfaqësojnë rreth 6% të totalit të mjeteve të korporatave jofinanciare.

DETYRIMET FINANCIARE


Në fund të vitit 2017, detyrimet financiare të korporatave jofinanciare shënojnë 2,646 miliardë lekë, me rënie vjetore prej 0.3%.

“Aksionet ose njësitë e fondeve të investimit” (AF.5) kanë financuar bizneset në nivelin 44% të totalit të detyrimeve financiare, dhe arritën nivelin 1,160 miliardë lekë nga 1,117 miliardë lekë në vitin 2016. Investitorët kryesorë janë ekonomitë familjare dhe jorezidentët, të cilët zotërojnë përkatësisht 37% dhe 43% të këtij instrumenti.


Detyrimet nën zërin “llogari të tjera të pagueshme” (AF.8) ranë në 760 miliardë lekë, nga 793 miliardë lekë një vit më parë. Ky zhvillim është diktuar kryesisht nga rënia e llogarive të pagueshme ndaj qeverisë në nivelin 167 miliardë lekë, nga 220 miliardë lekë në vitin 2016.

Një pjesë e rëndësishme e burimeve të përdorura për financimin e biznesit është siguruar përmes “huave” (AF.4), të cilat shënojnë 687 miliardë lekë, nga 704 miliardë në fund të vitit 2016. Huamarrja është siguruar kryesisht nga korporatat e tjera depozituese (sektori bankar), në masën 53%, si dhe nga sektori jorezident (37%). Zvogëlimi në stokun e kredisë nga korporatat depozituese është rrjedhojë njëkohësisht e masave për fshirjen e kredive me probleme, si dhe efektit negativ të kursit të këmbimit. Transaksionet (huamarrja e pastruar nga efekti i kursit të këmbimit dhe fshirjes së kredive), gjatë vitit 2017, shënuan rreth 10.8 miliardë lekë, nga rreth 5.9 miliardë një vit më parë. Huamarrja afatgjatë vijon mbizotëruese në nivelin e përgjithshëm të huave (në masën 75%).

Grafik 7. Ecuria e detyrimeve financiare të sektorit të korporatave jofinanciare (S11)




Grafik 8. Përbërja e llogarive të tjera të pagueshme për sektorin e korporatave jofinanciare (S11)



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

Pozicioni financiar neto i sektorit të korporatave jofinanciare u ngushtua me 16.4 miliardë lekë ose 1% në terma vjetorë, dhe në fund të vitit 2017 vlerësohet në -1,559 miliardë lekë.

Grafik 9. Pozicioni financiar neto i sektorit të korporatave jofinanciare (S.11)



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

4.2 NËNSEKTORI – KORPORATAT DEPOZITUESE PËRVEÇ BANKËS QENDRORE (S.122)

MJETET FINANCIARE

Mjetet financiare të korporatave depozituese përveç bankës qendrore (sektori bankar) u zgjeruan me 13.9 miliardë lekë dhe, në fund të vitit 2017, shënojnë 1,429 miliardë lekë.

“Huaja” (AF.4) mban pjesën më të madhe të mjeteve financiare të këtij nënsektori, me përafërsisht 44% të totalit, dhe gjatë 2017 u zvogëlua me 5.7 miliardë, në nivelin 635 miliardë lekë. Ecuria e stokut të huasë është influencuar nga reforma e ndërmarrë nga autoriteti rregullator për fshirjen e kredive me probleme nga bilancet e bankave (hyrë në fuqi nga 1 janari i vitit 2015), si dhe njëkohësisht nga efekti negativ i kursit të këmbimit. Kështu, vëllimi i transaksioneve në hua, pastruar nga efektet e mësipërme, llogaritet në 6.3 miliardë lekë, nga 31.4 miliardë lekë një vit më parë. Në masën më të madhe, transaksionet në hua kanë qenë në drejtim të sektorit të ekonomive familjare (në rreth 72%), ndërsa transaksionet në hua për sektorët jorezidentë shënojnë 5.8 miliardë lekë.

Portofoli në letra me vlerë të borxhit, i cili përfaqëson rreth 29% të mjeteve financiare të korporatave depozituese përveç bankës qendrore, shënoi rënie (9.5 miliardë lekë, ose 2.2% në terma vjetorë) dhe në fund të vitit 2017, arriti nivelin 416 miliardë lekë. Investimet në letra me vlerë të jorezidentëve nuk kanë qenë më atraktive, duke rënë me 19% gjatë vitit 2017, në një total prej 17.8% të totalit të portofolit, nga 22% një vit më parë. Letrat me vlerë të qeverisë qendrore u rritën me 2.5%, ndikuar kryesisht nga zgjerimi i zotërimeve në letra afatgjata të borxhit.

Instrumenti “monedha dhe depozita” (AF.2), gjatë vitit 2017, u zgjerua ndjeshëm me rreth 25.2 miliardë lekë në vlerë nominale (ose 7.7% në terma vjetorë), në nivelin 354.6 miliardë lekë, kryesisht si pasojë e zgjerimit të depozitave me afat (rreth 23.7 miliardë lekë vlerë nominale) dhe e zgjerimit të mjeteve likuide,



monedhës dhe depozitave të transferueshme (nominalisht me 1.5 miliardë lekë). Instrumenti “aksione ose njësi të fondeve të investimit” (AF.5), gjithashtu është zgjeruar gjatë vitit 2017 (me rreth 1.4 miliardë) dhe në fund të dhjetorit 2017 shënon 10.5 miliardë lekë. Ndërkohë, pesha e tyre ndaj totalit të aktiveve financiare mbetet e ulët, në nivelin 0.7 %.

DETYRIMET FINANCIARE

Detyrimet financiare të korporatave depozituese përveç bankës qendrore u zgjeruan me 37.4 miliardë lekë dhe, në fund të vitit 2017, shënojnë 1,395 miliardë lekë.

Instrumenti “monedha dhe depozita” (AF.2) përbën komponentin kryesor të detyrimeve financiare të korporatave depozituese përveç bankës qendrore, me një peshë ndaj totalit prej 83% në fund të vitit 2017. Gjatë këtij viti, ky instrument u zgjerua me 17.7 miliardë lekë, në nivelin 1,164 miliardë lekë.

Ky zhvillim është kryesisht pasojë e zgjerimit të depozitave të transferueshme (likuide) të sektorit të korporatave jofinanciare – me rreth 11.6 miliardë lekë.




Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

Huatë (AF.4) e korporatave depozituese përbëjnë vetëm 5% të totalit të detyrimeve financiare, me një vlerë prej 68 miliardë lekësh në fund të vitit 2017, ku huadhënësit kryesorë mbeten banka qendrore (58.5%) dhe sektori jorezident (36%).

Aksionet ose njësitë e fondeve të investimit (AF.5) arritën vlerën 148 miliardë lekë në fund të vitit 2017, në një peshë prej 10.6% të totalit të detyrimeve financiare, duke u rritur me 9.6 miliardë lekë krahasuar me vitin paraardhës.

Në fund të vitit 2017, pasuria financiare neto e korporatave depozituese përveç bankës qendrore vlerësohet në 34.05 miliardë lekë.

Grafik 12. Pasuria financiare neto e korporatave depozituese përveç Bankës qendrore



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

4.3 NËNSEKTORI – FONDET E INVESTIMEVE (S.124)

Fondet e Investimeve në Shqipëri e kanë nisur aktivitetin e tyre në fillim të vitit 2012. Menjëherë pas krijimit të tij, ky nënsektor ka pësuar një zhvillim të konsiderueshëm, duke kaluar përmes ndryshimesh të rëndësishme strukturore, në mbështetje të zhvillimit të tregut të kapitaleve në Shqipëri dhe tregut financiar në përgjithësi.

Aktualisht, numërohen tre fonde të hapura investimesh me ofertë publike të administruara nga dy shoqëri administruese, përkatësisht: Fondi i Investimeve “Raiffeisen Prestigje”, Fondi i Investimeve “Raiffeisen Invest Euro” dhe Fondi i investimit “Credins Premium”; me objekt investimi në tituj me të ardhura fikse, kryesisht bono dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare.

Ecuria e këtij tregu paraqitet në nivele të njëjta në vitet e fundit, dhe gjatë vitit 2017 shënoi një rritje në terma vjetorë me 11% të asetëve të tij. Nënsektori i fondeve të investimit (S.124) tashmë përfaqëson një pjesë të rëndësishme të sektorit financiar në Shqipëri duke mbetur nënsektori i dytë më i rëndësishëm, pas nënsektorit të korporatave të tjera depozituese.

MJETET FINANCIARE


Mjetet financiare të fondeve të investimeve, në fund të vitit 2017, shënuan 72.9 miliardë lekë, nga 65.6 miliardë lekë në vitin 2016. Pretendimet financiare të fondeve të investimeve në totalin e mjeteve të korporatave financiare (S.12) zënë rreth 3.5%. Gjatë viti 2017 vërehet një rritje e moderuar e prezencës së këtij sektori në sektorin financiar.

Në aspektin e politikës së investimeve, ato dominohen kryesisht nga investime në letra me vlerë të borxhit (në masën 85%), të cilat përbëjnë edhe instrumentin më të rëndësishëm financiar të mbajtur nga ky nënsektor.


Instrumenti “letra me vlerë të borxhit” (AF.3) u rrit në terma vjetorë me rreth 12.8% dhe në fund të vitit 2017, shënon vlerën 62.2 miliardë lekë, nga të cilat 49.3 miliardë lekë përfaqësohen nga letra me vlerë të borxhit afatgjatë.

Mjetet financiare në formën “monedha dhe depozita” (AF.2) kanë shënuar një rënie gjatë vitit 2017 me rreth 24%, dhe në fund të 2017 shënojnë 5.8 miliardë lekë.

Grafik 13. Mjetet financiare të sektorit të фондеве të investimeve (s.124)



Grafik 14. Investimet në letrat me vlerë të borxhit



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

DETYRIMET FINANCIARE

Totali i detyrimeve financiare të фондеве të investimeve u rrit me 11% gjatë vitit 2017, në nivelin 72.9 miliardë lekë.

Në konsiderata të llojit të ndërmjetësimit financiar që kryhet nga fondet e investimeve, detyrimi kryesor financiar i këtij nënsektori është në kuota (njësi) të fondit të investimit (AF.52), të cilat përbëjnë 99.7% të detyrimeve financiare, në fund të vitit 2017. Në terma absolutë, stoku i këtij instrumenti, gjatë vitit 2017, ka patur një rritje me 11%, krahasuar me rënien prej 2% të shënuar në fund të vitit 2016. Investitorë në fondet e investimeve janë individët.

4.4 NËNSEKTORI – INSTITUCIONE TË TJERA FINANCIARE PËRVEÇ KOMPANIVE TË SIGURIMIT DHE FONDEVE TË PENSIONIT (S.125+S.126+S.127)

Nënsektori “institucione të tjera financiare përveç kompanive të sigurimit dhe фондеве të pensionit” (S125+S.126+S.127), agregon të dhënat e të gjithë institucioneve të tjera që kryejnë ndërmjetësim financiar apo lehtësojnë ndërmjetësimin financiar, të tilla si: institucionet e kreditit, institucionet që ofrojnë qira financiare (leasing), institucionet e mikrokredisë, faktoringut, dhe të gjitha shërbimeve të pagesave dhe transferimit të parave, brokerat dhe agjentët financiarë etj. Sipas standardit metodologjik ESA 2010, llogaria financiare duhet të paraqitet e detajuar për nënsektorin “ndërmjetësit e tjerë financiarë” (S.125) dhe “ndihmësit financiarë” (S.126+S.127). Meqenëse në sektorin financiar shqiptar, secili nënsektor i veçuar zë një peshë mjaft të vogël, është gjykuar që të paraqiten në nënsektorin “Institucione të tjera financiare përveç kompanive të sigurimit dhe фондеве të pensionit”. Së bashku, këta nënsektorë përfaqësojnë vetëm 2.4% në totalin e mjeteve të korporatave financiare (S.12).

MJETET FINANCIARE


Mjetet financiare të institucioneve të tjera financiare përveç kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit u zgjeruan me 6.5 miliardë lekë (ose 14.7% në terma vjetorë) dhe, në fund të vitit 2017, shënojnë 51 miliardë lekë.

Instrumenti kryesor i këtij nënsektori mbetet "huaja" (AF.4), me një peshë prej 50% në totalin e mjeteve financiare. Gjatë vitit 2017, ky instrument u rrit me 16%, krahasuar me një vit me parë, dhe shënon nivelin 25.7 miliardë lekë në fund të vitit 2017. Në një shpërndarje sipas maturitetit, huatë afatgjata janë dominuese, me rreth 88.7% të totalit të huave në fund të vitit 2017. Sektori kryesor përthithës i tyre është sektori i ekonomive familjare, i cili ka përfituar rreth 70% të huave të dhëna nga institucionet e tjera financiare.


Instrumenti "monedha dhe depozita" (AF. 2) përbën rreth 18.9% të totalit të mjeteve financiare të këtij nënsektori, dhe shënon 9.6 miliardë lekë në fund të vitit 2017, nga 9.8 miliardë në vitin 2016.

Instrumenti "aksione ose njësi të fondit të investimit" (AF.5) vlerësohet në 10.3 miliardë lekë dhe përbën 20.2% të totalit të mjeteve në fund të vitit 2017. Investimi në kapitalin e korporatave të tjera depozituese zë peshën kryesore për të gjitha periudhat e marra në shqyrtim (73.6% të totalit të aksioneve).

Grafik 15. Mjetet financiare të institucioneve të tjera financiare (S.125+S.126+S.127)



Grafik 16. Detyrimet financiare të institucioneve të tjera financiare (S.125 + S.126 + S.127)



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

DETYRIMET FINANCIARE

Detyrimet financiare të institucioneve të tjera financiare vlerësohen në nivelin 43.8 miliardë lekë, nga 41.4 miliardë lekë në fund të vitit 2016.

Burimi kryesor i financimit të këtij nënsektori janë huatë (AF.4) me rreth 46% të totalit të detyrimeve, të cilat, në fund të vitit 2017, shënojnë nivelin stok prej 20 miliardë lekësh. Sektorët kryesorë financues të huasë janë korporatat e tjera depozituese në rreth 37% dhe jorezidentët në 39% të totalit të detyrimeve të vlerësuara në fund të vitit 2017.

Instrumenti "aksione ose njësi të fondit të investimit" (AF.5), në fund të vitit 2017 shënon 18.7 miliardë lekë, në zgjerim me rreth 1 miliardë lekë, dhe përbën rreth 43% të totalit të detyrimeve financiare.

Në fund të vitit 2017, pasuria financiare neto e këtij nënsektori shënonte nivelin 7.1 miliardë lekë, nga 3 miliardë lekë një vit më parë.

4.5 NËNSEKTORI – KOMPANITË E SIGURIMIT (S.128) DHE FONDET E PENSIONIT (S.129)

Tregu shqiptar i sigurimeve vijon me një rritëm relativisht të qëndrueshëm zgjerimi, me total mjetesh financiare që luhaten në intervalin 1.88-1.87% e PBB-së, për periudhën 2016-2017. Numri i shoqërive operuese në tregun e sigurimeve ka mbetur po njësoj gjatë këtij viti, në 11 kompani.

Megjithatë, tregu i sigurimeve në Shqipëri mbetet i orientuar tek sigurimet e jo-jetës, dhe kryesisht tek ato të detyrueshme.

Gjithashtu, dinamikë pozitive kanë patur zhvillimet në tregun e pensioneve private vullnetare. Gjithsesi, vlera neto e mjeteve të këtij tregu është në masë të papërfillshme kundrejt PPB-së në Shqipëri. Gjatë vitit 2017, numri i operatorëve të tregut të pensioneve private vullnetare nuk pati ndryshime. Në këtë treg ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde pensioni vullnetar të administruar nga tri shoqëri administruese.


MJETET FINANCIARE

Gjatë vitit 2017, mjetet financiare të kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit së bashku shënuan 29 miliardë lekë, në zgjerim vjetor me 4.8%. Së bashku këta nënsektorë përfaqësojnë vetëm 1.4% në totalin e mjeteve të korporatave financiare (S.12).


"Monedha dhe depozitat" (AF.2) përfaqësojnë instrumentin kryesor në zgjerimin e mjeteve financiare, të kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit (në rreth 35.8% të totalit të mjeteve). Në fund të 2017, ky instrument shënoi 10.4 miliardë lekë dhe prezantohet në masë të konsiderueshme (94%), kryesisht nga depozitat me afat pranë korporatave depozituese (AF.29). "Letra me vlerë të borxhit" (AF.3) është një tjetër instrument i rëndësishëm financiar i mbajtur nga këta nënsektorë. Në fund të 2017, letrat me vlerë të borxhit shënuan 5.2 miliardë lekë, në rritje vjetore prej 1%. Letra me vlerë të borxhit përfaqësojnë në masën 18% totalin e mjeteve financiare dhe prezantohen tërësisht në formën e letrave me vlerë të borxhit të emetuar nga qeveria qendrore.

Llogaritë e tjera të arkëtueshme të kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit shënuan vlerën 4.85 miliardë lekë, nga 4.6 miliardë lekë në fund të vitit 2016.

Grafik 17. Ecuria e mjeteve financiare të sektorit të kompanive të sigurimeve dhe fondeve të pensioneve (S.128+S.129)



Grafik 18. Ecuria e detyrimeve financiare të sektorit të kompanive të sigurimeve dhe fondeve të pensioneve (S.128+S.129)



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

DETYRIMET FINANCIARE

“Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit të jetës dhe pensionit vjetor” (AF.6) janë detyrimet kryesore financiare të nënsektorit të kompanive të sigurimit dhe fondeve të pensionit. Në fund të vitit 2017, stoku i tyre shënon 18.8 miliardë lekë dhe përbën 57.6% të detyrimeve financiare. Peshën kryesore të këtij detyrimi e përbëjnë rezervat e sigurimit të jo-jetës (me 82% të totalit).

“Aksione ose njësi të fondeve të investimit” (AF.5) ose llogaria e kapitaleve të veta, është një tjetër instrument i rëndësishëm financiar në totalin e detyrimeve financiare të këtij nënsektori (me rreth 30%). Në fund të vitit 2017, ky instrument vlerësohet në rreth 9.9 miliardë lekë, në rritje të moderuar në terma vjetorë (1.4%).

Në fund të 2017, pozicioni financiar neto i kompanive të sigurimeve dhe fondeve të pensionit shënon -3.7 miliardë lekë.

4.6 SEKTORI – QEVERIA E PËRGJITHSHME (S.13)


MJETET FINANCIARE

Mjetet financiare të qeverisë së përgjithshme, në fund të vitit 2017, shënojnë 492 miliardë lekë, nga 538 miliardë një vit më parë, me rënie vjetore prej 8%. Ato prezantohen kryesisht në aksione/pjesëmarrje në kapital në korporata publike jofinanciare dhe në llogari të tjera të arkëtueshme kryesisht kundrejt biznesit, respektivisht në rreth 45% dhe 35% (Grafik 19).

Në fund të vitit 2017, instrumenti “aksione/pjesëmarrje në kapital” (F5) vlerësohet në 223 miliardë lekë, nga 238 miliardë lekë në një vit më parë. Mjetet financiare të përfshira në instrumentin “llogari të tjera të arkëtueshme” (AF.8), i cili përfshin pretendimet e autoriteteve publike ndaj agjentëve ekonomikë, të tilla si komisione, taksa dhe sigurimet shoqërore, për 2017, vlerësohen në 172 miliardë lekë, nga 224 miliardë në fund të 2016. “Monedha dhe

depozita" (AF.2) u zgjeruan në nivelin 48 miliardë lekë, nga 34 miliardë lekë në vitin 2016. Huatë (AF.4) e dhëna nga qeveria e përgjithshme u rritën me rreth 18% gjatë vitit. Në terma nominalë ky tregues shënon 49 miliardë, nga 42 miliardë lekë në fund të vitit 2016.

Grafik 19. Ecuria e mjeteve financiare të Qeverisë së përgjithshme (S.13)




Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

DETYRIMET FINANCIARE


Detyrimet financiare të sektorit të qeverisë së përgjithshme vlerësohen në nivelin 1,210 miliardë lekë, nga 1,187 miliardë lekë në fund të vitit 2016.

Instrumenti kryesor i financimit i përdorur nga qeveria e përgjithshme vijon të jenë "letrat me vlerë të borxhit" (AF.3), të cilat përbëjnë rreth 48% të totalit të detyrimeve. Në terma absolutë, letrat me vlerë afatgjata të borxhit gjenden në nivelin 406 miliardë, nga 373 miliardë një vit më parë, ndërkohë letrat me vlerë afatshkurtra (deri në një vit) ranë në nivelin 181 miliardë, nga 189 miliardë në vitin 2016. Mbjatësit kryesorë të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë janë korporatat e tjera depozituese, në një total prej 343 miliardë lekë.

Grafik 20. Ecuria e detyrimeve financiare të Qeverisë së përgjithshme (S.13)



Grafik 21. Struktura e borxhit të Qeverisë së përgjithshme sipas sektorëve të ekonomisë



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.


“Huatë afatgjata” (AF.4), ashtu si letrat me vlerë, kanë luajtur rol të rëndësishëm si instrument financues për qeverinë e përgjithshme, dhe zënë 36% të detyrimeve totale. Në fund të vitit 2017, huatë arritën nivelin 434 miliardë lekë, nga 422 miliardë lekë në vitin 2016, me një rritje vjetore prej 2.7%.

Financuesi kryesor i borxhit të qeverisë së përgjithshme (hua dhe letra me vlerë) është sektori i jorezidentëve, i cili mban rreth 46% të totalit, i shoqëruar nga sektori i korporatave të tjera depozituese në rreth 34%.

Detyrimet financiare në formën e llogarive të pagueshme (AF.8) të vlerësuara në llogaritë financiare, në terma absolutë shënuan rreth 190 miliardë lekë në fund të vitit 2017, nga rreth 203 miliardë lekë në fund të vitit 2016.

Në vitin 2017, pozicioni financiar neto i qeverisë së përgjithshme, në raport me PBB-në, llogaritet në nivelin -46.2%, nga rreth -44% një vit më parë.

Grafik 22. Pozicioni financiar neto i sektorit Qeveria e përgjithshme (S.13)



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

4.7 SEKTORI – EKONOMITË FAMILJARE (S.14 +S.15)⁸

MJETET FINANCIARE

Në fund të vitit 2017, totali i mjeteve financiare të ekonomive familjare, vlerësuar në llogaritë financiare, shënon 1,763 miliardë lekë, nga 1,781 miliardë lekë në fund të 2016 (Grafik 23).

Instrumenti kryesor përdorur nga ekonomitë familjare është “monedha dhe depozita” (AF. 2), i cili përfaqëson në masën 56.4% mjetet financiare të këtij sektori. Në harkun kohor të një viti, monedha dhe depozitat shënuan një zgjerim me rreth 12 miliardë lekë, duke shënuar nivelin 995 miliardë lekë në fund të 2017. Gjatë vitit, individët/ekonomia familjare ka zgjeruar mjetet likuide (të tilla si cash/monedha dhe depozitat e transferueshme) dhe ka ngushtuar investimet në depozita më afat. Kështu, monedha dhe depozitat e transferueshme, gjatë vitit, u zgjeruan me rreth 14 mld lekë në nivelin 423

⁸ Përfshirë këtu ekonomitë familjare (S.14) dhe institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të individëve (S.15).

miliardë lekë, ndërkohë që depozitat me afat ranë me 2 miliardë dhe, në fund të vitit 2017, shënuan 573 miliardë lekë.

Në të njëjtën kohë, portofoli i individëve në “investime në letrat me vlerë të borxhit” (AF.3) u zgjerua (15%) në nivelin 92 miliardë lekë, në drejtim të zgjerimit të investimeve në letra me vlerë të borxhit afatgjata (zgjeruar nominalisht me 18 miliardë lekë), ndërkohë që portofoli afatshkurtër është tkurrur me 6 miliardë lekë. Letrat me vlerë përbëjnë vetëm 5% të totalit të mjeteve financiare të sektorit të ekonomive familjare.

Aksionet dhe njësitë e fondeve të investimit zënë 32% të totalit të mjeteve financiare dhe shënojnë nivelin stok prej 568 miliardë lekësh, nga 613.5 miliardë lekë një vit më parë. Ndikimin më të madh në këtë rënie e pati kapitali i investuar në korporatat jofinanciare, i cili shënon një rënie vjetore prej 53.5 miliardë lekësh (ose 11%).


“Llogari të tjera të arkëtueshme” (AF.8), gjatë vitit, u rrit me 3% dhe në fund të 2017, shënon 101.4 miliardë lekë.

DETYRIMET FINANCIARE


Në 2017, detyrimet financiare të sektorit të ekonomive familjare vlerësohen në 205.9 miliardë lekë, në rritje prej 11.9 miliardë lekësh (ose 6%) referuar një viti më parë. Huatë (AF. 4) mbajnë peshën kryesore në totalin e detyrimeve financiare të këtij sektori (95% të totalit). Në fund të 2017, stoku i huave shënon rreth 195 miliardë lekë, nga 183 miliardë lekë në vitin 2016. Në terma maturiteti, huatë afatshkurtra ranë me 0.3 miliardë lekë, ndërkohë huatë afatgjata, të cilat përbëjnë 95% të totalit të huave të ekonomive familjare, u rritën me 12 miliardë lekë ose 7%.

Llogari të tjera të pagueshme, në fund të vitit 2017, shënon vlerën e 10.9 miliardë lekëve, duke ruajtur kështu pothuajse të njëjtin nivel të një viti më parë.

Grafik 23. Mjetet financiare të sektorit të ekonomive familjare (S.14 + S.15)




Grafik 24. Detyrimet financiare të sektorit të ekonomive familjare (S.14 + S.15)



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

Për vitin 2017, pasuria financiare neto e ekonomive familjare vlerësohet në 1557.9 miliardë lekë, nga 1,587.4 miliardë lekë në vitin 2016, ose në rënie vjetore prej 2% (Grafik 25).



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

4.8 SEKTORI –JOREZIDENT (S.2)


Sektori jorezident, i cili përfaqëson detyrimet e huaja të sektorëve të ekonomisë shqiptare, vijon të ruajë nivelin e 23% në totalin e përgjithshëm të mjeteve financiare. Gjatë vitit 2017, gjendja financiare e këtij sektori u karakterizua nga rritje e ndjeshme e aktivitetit në kahun e mjeteve dhe ngushtim në kahun e detyrimeve. Këto zhvillime rezultuan në thellimin e mëtejshëm të huadhënies neto të këtij sektori me rreth 102 miliardë lekë, në nivelin 702 miliardë lekë në fund të 2017. Në terma relativë kundrejt PBB-së, huadhënia neto e sektori jorezident është thelluar me 4 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 45%.

MJETET FINANCIARE


Në fund të vitit 2017, stoku i mjeteve financiare të sektorit jorezident shënon 1,689 miliardë lekë, në zgjerim me 90 miliardë lekë (ose 6% në terma vjetorë). Ndërkohë, fluksi hyrës nga ky sektor në drejtim të sektorëve të tjerë rezidentë, gjatë vitit 2017, vlerësohet në rreth 155 miliardë lekë, dhe rreth 65 miliardë lekë llogaritet kryesisht efekti negativ i luhatjeve të kursit të këmbimit dhe ndryshimeve të tjera në pozicionin/stok. Financimi i huaj në formën e huave (AF.4) dhe investimeve në kapital (AF.5) përfaqëson ndër vite dimensionin kryesor të ndërlidhjes së këtij sektori me sektorët rezidentë të ekonomisë shqiptare - respektivisht rreth niveleve 43% dhe 37% në fund të vitit 2017.

Huatë (AF.4) u zvogëluan me 9 miliardë lekë dhe, në fund të vitit 2017, vlerësohen në nivelin 719 miliardë lekë. Ndërkohë, investimet në formën e marrëdhënieve në kapital (AF.5) patën dhe rritjen më të ndjeshme gjatë vitit 2017, rreth 100 miliardë lekë, duke kapur vlerën prej 630 miliardë lekësh.

Grafik 26. Ecuria e mjeteve financiare të sektorit jorezident (S.2)



Grafik 27. Përbërja e huave të sektorit jorezident



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

Qeveria qendrore është përfituesi kryesor i financimit të huaj në formën e huave (me 60% të totalit). Nga ana tjetër, sektori i korporatave jofinanciare është përthithësi kryesor i investimeve të huaja direkte (78% e investimeve në formën e investimeve në kapital).


Nga pikëpamja e transaksioneve (fluksi) të zhvilluara gjatë vitit 2017 ndërmjet sektorit jorezident dhe ekonomisë vendase (sektorëve të tjerë rezidentë), mjetet financiare janë shfaqur dinamike, ku ndikimin kryesor e kanë dhënë investimet e kapitalit në sektorin e korporatave jofinanciare (+80% të totalit të transaksioneve). Përpos kësaj, sektori i qeverisë qendrore ka përbërë +23% të transaksioneve të vitit 2017, si rezultat i zgjerimit të borxhit të jashtëm.

DETYRIMET FINANCIARE


Gjatë vitit 2017, stoku i detyrimeve financiare të sektorit jorezident ndaj sektorëve të tjerë rezidentë të ekonomisë shqiptare, pësoi tkurrje me 12 miliardë lekë, në nivelin 986 miliardë lekë në fund të dhjetor 2017. Transaksioni/fluksi i pastruar për efekt të kursit të këmbimit vlerësohet në rreth 30 miliardë lekë. Edhe pse lëvizjet përgjatë instrumenteve financiare janë shumë dinamike, karakteristikë përgjatë vitit mbetet preferenca për investime në depozita, kundrejt atyre në letra me vlerë.

Për rrjedhojë, në përbërjen e detyrimeve sipas instrumenteve, peshën kryesore këtë vit e mbajnë investimet në depozita (AF.2) – në rreth 40% të totalit - të cilat zotërohen kryesisht nga Banka Qendrore (në kuadër të investimeve të rezervës valutore (Grafik 29). Gjatë vitit 2017, stoku i detyrimeve financiare në trajtën e letrave më vlerë të borxhit u ngushtua ndjeshëm me 82 miliardë lekë në terma nominalë.

Grafik 28. Ecuria e detyrimeve financiare të sektorit jorezident (S.2)



Grafik 29. Përbërja e letrave me vlerë të borxhit të sektorit jorezident




Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

Në të njëjtën kohë, zgjerimi i detyrimeve financiare përmes instrumentit “monedha dhe depozita”, me rreth 88 miliardë në 391 miliardë lekë, u diktua kryesisht nga “investime në depozita të transferueshme” (AF.22) të bankës qendrore dhe bankave të nivelit të dytë.

Në fund të vitit 2017, huadhënia neto e sektorit jorezident vlerësohet në 702 miliardë lekë ose 45% e PBB-së.

Grafik 30. Pasuria financiare neto sektorit e jorezident (S.2)



Burimi: Departamenti i Statistikave Financiare.

SHTOJCË STATISTIKORE

Tabela 1. Stoku i mjeteve financiare të sektorëve institucionalë.

në miliardë lekë

	2013	2014	2015	2016	2017
Totali i ekonomisë	6,250	6,545	6,788	7,033	7,107
Ari monetar dhe SDR	24	27	39	35	33
Monedha dhe depozitat	1,541	1,609	1,769	1,883	2,015
Letra me vlere te borxhit	899	1,020	995	1,022	965
Huatë	1,523	1,454	1,467	1,533	1,532
Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit	1,230	1,274	1,414	1,468	1,515
Dervatët financiare	0	0	0	0	0
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit te jetes dhe pensionit vjetor	12	15	18	21	22
Llogari te tjera te arketueshme/pagueshme	1,022	1,146	1,086	1,071	1,025
Korporatat financiare	1,753	1,853	1,933	2,036	2,075
Ari monetar dhe SDR	17	19	31	27	26
Monedha dhe depozitat	317	328	445	461	542
Letra me vlere te borxhit	749	809	768	802	744
Huatë	635	663	649	696	704
Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit	14	14	19	22	28
Dervatët financiare	0	0	0	0	0
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit te jetes dhe pensionit vjetor	4	4	5	5	5
Llogari te tjera te arketueshme/pagueshme	17	16	16	23	26
Qeveria e përgjithshme	482	464	528	538	492
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozitat	28	23	37	34	48
Letra me vlere te borxhit	-	-	-	-	-
Huatë	58	59	36	42	49
Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit	226	215	237	238	223
Dervatët financiare	-	-	-	-	-
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit te jetes dhe pensionit vjetor	-	-	-	-	-
Llogari te tjera te arketueshme/pagueshme	169	166	218	224	172
Korporatat jo-financiare	1,063	1,073	1,036	1,078	1,088
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozitat	143	177	186	247	269
Letra me vlere te borxhit	-	57	62	61	50
Huatë	187	73	66	65	57
Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit	59	58	40	63	66
Dervatët financiare	-	-	-	-	-
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit te jetes dhe pensionit vjetor	7	9	10	14	14
Llogari te tjera te arketueshme/pagueshme	666	699	672	629	632
Ekonomia familjare dhe Institucionet jo me qëllim fitimi	1,675	1,767	1,792	1,781	1,764
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozitat	915	938	955	984	996
Letra me vlere te borxhit	72	76	83	80	92
Huatë	4	5	2	2	3
Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit	569	569	668	614	568
Dervatët financiare	-	-	-	-	-
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit te jetes dhe pensionit vjetor	1	2	2	3	3
Llogari te tjera te arketueshme/pagueshme	114	176	80	99	101
Joresidentët (pjesa tjetër e botës)	1,277	1,388	1,500	1,599	1,689
Ari monetar dhe SDR	7	8	8	8	7
Monedha dhe depozitat	138	143	146	157	160
Letra me vlere te borxhit	78	78	82	79	78
Huatë	639	654	714	729	719
Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit	360	418	451	531	631
Dervatët financiare	-	-	-	-	-
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit te jetes dhe pensionit vjetor	-	-	-	-	-
Llogari te tjera te arketueshme/pagueshme	55	88	99	95	93

Tabela 2. Stoku i detyrimeve financiare të sektorëve institucionalë.

në miliardë lekë	2013	2014	2015	2016	2017
Totali i ekonomisë	6,250	6,545	6,788	7,033	7,107
Ari monetar dhe SDR	24	27	39	35	33
Monedha dhe depozitat	1,541	1,609	1,769	1,883	2,015
Letra me vlere te borxhit	899	1,020	995	1,022	965
Huatë	1,523	1,454	1,467	1,533	1,532
Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit	1,230	1,274	1,414	1,468	1,515
Dervatët financiare	0	0	0	0	0
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit te jetes dhe pensionit vjetor	12	15	18	21	22
Llogari te tjera te arketueshme/pagueshme	1,022	1,146	1,086	1,071	1,025
Pozicioni financiar neto	0	0	0	0	0
Korporatat financiare	1,706	1,807	1,901	2,000	2,058
Ari monetar dhe SDR	7	8	8	8	7
Monedha dhe depozitat	1,363	1,430	1,508	1,580	1,624
Letra me vlere te borxhit	0	0	6	6	7
Huatë	76	81	58	77	89
Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit	226	258	283	293	295
Dervatët financiare	-	-	-	-	-
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit te jetes dhe pensionit vjetor	10	12	16	18	19
Llogari te tjera te arketueshme/pagueshme	23	18	21	18	18
Pozicioni financiar neto	47	46	32	37	17
Qeveria e përgjithshme	974	1,031	1,142	1,187	1,210
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozitat	-	-	-	-	-
Letra me vlere te borxhit	542	569	557	562	587
Huatë	292	343	406	422	434
Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit	-	-	-	-	-
Dervatët financiare	-	-	-	-	-
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit te jetes dhe pensionit vjetor
Llogari te tjera te arketueshme/pagueshme	140	118	179	203	190
Pozicioni financiar neto	-492	-567	-614	-649	-718
Korporatat jo-financiare	2,598	2,718	2,639	2,653	2,646
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozitat	-	-	-	-	-
Letra me vlere te borxhit	47	48	37	39	39
Huatë	764	741	704	704	687
Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit	975	987	1,083	1,118	1,160
Dervatët financiare	-	-	-	-	-
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit te jetes dhe pensionit vjetor	-	-	-	-	-
Llogari te tjera te arketueshme/pagueshme	812	942	815	794	760
Pozicioni financiar neto	-1,535	-1,645	-1,603	-1,575	-1,559
Ekonomia familjare dhe Institucionet jo me qëllim fitimi	192	190	200	194	206
Ari monetar dhe SDR	-	-	-	-	-
Monedha dhe depozitat	-	-	-	-	-
Letra me vlere te borxhit	-	-	-	-	-
Huatë	165	167	176	183	195
Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit	-	-	-	-	-
Dervatët financiare	-	-	-	-	-
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit te jetes dhe pensionit vjetor	-	-	-	-	-
Llogari te tjera te arketueshme/pagueshme	27	23	24	11	11
Pozicioni financiar neto	1,483	1,577	1,592	1,587	1,558
Joresidentët (pjesa tjetër e botës)	780	799	907	998	986
Ari monetar dhe SDR	17	19	31	27	26
Monedha dhe depozitat	177	179	261	303	391
Letra me vlere te borxhit	310	402	395	415	332
Huatë	225	122	123	147	128
Kapitali dhe aksionet/kuotat e fondit të investimit	29	30	48	57	60
Dervatët financiare	0	0	0	0	0
Rezervat teknike dhe skemat e sigurimit te jetes dhe pensionit vjetor	2	3	2	3	3
Llogari te tjera te arketueshme/pagueshme	20	45	46	46	45
Pozicioni financiar neto	496	589	593	600	702